

# ***RAPORT – LEHTËSISHT I LEXUESHËM***

**ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË SË KUADRIT LIGJOR TË KOSOVËS  
ME KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E  
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

QASJA DHE PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE





- Ky është versioni i shkurtër I raportit.

Një raport më i gjatë është përgatitur për të njëjtin qëllim.



- Për këtë raport, të dhënat janë mbledhur sipas metodologjisë së projektit, ekspertit, ligjeve, diskutimeve me PAK dhe takimeve me grupin punues.

PAK- Persona me Aftësi të Kufizuar



- Raporti përmban analizën dhe formën e përmbledhur të Kornizës Ligjore të Kosovës dhe rekomandimet e nevojshme për ndërhyrje.



- Një raport i ngjashëm është bërë edhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri.

Raportet kanë për qëllim avokimin në nivel kombëtar dhe rajonal për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.



- Qëllimi i raportit është për të dhënë një pasqyrë sa më të saktë se sa ka rregulluar Kosova me ligj të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.



- Aktet ligjore me fokus qasjen dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike në krahasim me KDPAK. dhe

A ka institucione që kujdesen për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar ?



- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ka hyrë në fuqi nga viti 2008.

E kanë ratifikuar 186 shtete/164 ënshkruar. Protokolli i saj është ratifikuar nga 104 shtete/94 nënshkruar.



- Konventa (KDPK), është dokument i detyrueshëm ndërkombëtarë për shtetet të cilat e kanë pranuar dhe ratifikuar atë.

Konventa ka për qëllim të siguron që shtetet i respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Prandaj, Konventa ka kërkuar që shtetet të harmonizojnë legjislacionin e tyre me Konventën.



- KNDPAK aktualisht nuk është e zbatueshme në Kosovë.

Kosova nuk mund të jetë palë meqenëse nuk është shtet anëtarë I OKB-së.



- Në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marrë vendim që Konventa të përfshihet në nenin 22 të Kushtetutës.

Kur të ndodhë kjo, Konventa do të jetë e zbatueshme në Kosovë dhe do të këtë epërsi ndaj ligjeve të Kosovës.




- Kushtetuta e Kosovës siguron barabarësi dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë njësoj.

Kosova e ka adresuar aftësinë e kufizuar në legjislacionin e Kosovës.

Ligjet për aftësinë e kufizuar i kanë trajtuar personat me aftësi të kufizuar sipas llojeve të aftësisë së kufizuar.


P.sh. Ka ligje që mbështesin financiarisht personat e verbër, personat paraplegjik dhe tetraplegjik, personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike.

Ka edhe ligje tjera që rregullojnë çështje të ndryshme në shoqëri e që kanë dispozita për aftësinë e kufizuar.



- Edhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi e ka njohur aftësinë e kufizuar si bazë për diskriminim.

PAK mund të ngrehin padi nëse besojnë se janë duke u diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.



- Për këtë raport i kemi analizuar vetëm ligjet që kanë përfshirë qasjen dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike.



- Në KDPK, qasja është në nenin 9 dhe pjesëmarrja në jetën publike dhe politike në nenin 29.



- Ka disa Komitete në kuadër të Konventës të cilët japin rekomandime se si me u zbatuar nenet e Konventës.

Komitetet e KB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar janë mekanizma të Konventës.




- Në këtë raport ne kemi përfshirë disa rekomandime të Komiteteve për qasje dhe pjesëmarrje.

Të gjitha rekomandimet janë të rëndësishme.

Por fjalët kyçe për qasjen janë:

- jetesë e pavarur
- pjesëmarrja efektive në shoqëri.



• Fjalët kyçe për pjesëmarrjen janë:

- pjesëmarrja në votime dhe zgjedhje
- përfaqësimi në institucione publike.

Të gjitha këto vlejné në raport me:

- institucionet publike dhe private që janë në shërbim të publikut
- duhet të aplikohen për zonat urbane dhe rurale.




• Të gjitha këto që garanton Konventa dhe Komitetet janë analizuar nëse janë në:

- legjislacionin e Kosovës, dhe
- nëse legjislacioni i Kosovës është i ngjashëm me Konventën.



• Kemi konstatuar që ligjet në Kosove nuk janë në harmoni me Konventën sa i përket qasjes dhe pjesëmarrjes.



- Kur flasim për qasjen, jemi duke menduar për:
  - Mjedisin fizik,
  - Transportin publik,
  - Informimin dhe Komunikimin, TIK dhe
  - Shërbimet Publike



- Mjedisi fizik janë:

Rrugët, trotuaret, qendra e qytetit, hapësirat publike, parqet, institucionet publike, shëndetësore, spitalet, rekreacion, shkollat, edukative, kulturore, turistike, parkingjet, hyrjet në ndërtesa .




Ka disa ligje që i adresojnë disa nga këto, por jo në mënyrë të plotë.





• **Transporti publik përfshin:**

- autobusët, aeroplanët, varkat, tramvajet, taksitë, furgonët;
- stacione, stacione autobusi, aeroporte, rrugë, ura, vendkalime për këmbësorë, trotualet;
- tabelat në stacionet e autobusëve, oraret, hartat, informacionet për udhëtarët në aeroporte;
- informacione të qasshme brenda tramvajeve, trenave, autobusëve, etj.;
- për ndalesat aktuale dhe të ardhshme, procedurat e urgjencës, si të telefononi për ndihmë;
- Platforma dixhitale që ofrojnë në kohë reale informacion mbi sistemin e transportit;
- shërbimet e internetit për të rezervuar një biletë ose procedurat për ankesë.



Shumë nga këto çështje mungojnë në ligje.





• **Komunikimi dhe informimi I referohet:**

- Informacionit, komunikimit dhe shërbimeve të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës, por nuk kufizohet vetëm në këto

- përfshinë ndër të tjerat edhe teknologjinë e informacionet dhe komunikimit (TIK), si arritje moderne e zhvillimit aktual.

Disa çështje i gjejmë në ligje, por janë të shpërndara, ka disa çështje që nuk janë fare në ligje.



• **Në shërbime publike hyjnë por nuk kufizohen:**

- kujdesi shëndetësor,
- edukimi/arsimi,
- energjia,
- shërbimet ligjore,
- telekomunikacioni,
- shërbimet e transportit dhe infrastrukturës së transportit,
- planifikimi urban,
- shërbimet e emergjencës,
- furnizimi me ujë,





- mbrojtja e ambientit,
- shërbimet sanitare,
- shërbimet postare,
- shërbimet e rekreacionit,
- programet ekonomike dhe të agrikulturës, shërbimet sociale,
- ndërtesat publike.

Edhe për këtë fushë, për disa ka ligje për disa nuk ka. Disa që janë, nuk janë të plota.



- Prandaj përfundojmë se Legjislacioni nuk e adreson në tërësi fushën e qasjes. Ka komponentë që nuk adresohen fare në legjislacion.

Disa herë dispozitat ligjore janë të shpërndara në ligje të ndryshme.

Disa janë të fragmentuara që d.m.th. një çështje adresohet në 2 ose më shumë vende.

Disa janë të pa plota, që d.m.th. diçka rregullojnë e diçka jo.





- Kur flasim për pjesëmarrjen jemi duke folur për:

- daljen në votime,
- të qenët kandidatë në zgjedhje,
- të bërit fushatë publike,
- të përfshirë në poste publike,
- për të marrë pjesë në OJQ,
- për të krijuar një OJQ,
- për të marrë pjesë në takime të ndryshme si në Kosovë, në regjion ose kudo në botë.



- Ligji për zgjedhje të përgjithshme e ka trajtuar deri diku mirë votimin e personave me aftësi të kufizuara. Edhe pse në realitet ka barrierat fizike për të marrë pjesë në votime.



Çka mungon në këtë çështje është një kriter për partitë politike që të përfshi PAK në listat zgjedhore.



- **Përfaqësimi në institucione publike është shumë i ulët edhe pse ligji nuk e ndalon.**

**Njësoj është edhe pjesëmarrja në takime në nivel lokal, rajonal dhe dërkombëtare. Formimi i OJQ-ve dhe pjesëmarrja është e rregulluar me ligj, njësoj sikur për organizatat tjera.**

**Ajo çka mungon është me përcaktuar statusin e OPAK-ve.**



- **Përfundojmë se marrja pjesë në votime është më mirë e rregulluar në ligj. Edhe Kushtetuta e ka rregulluar atë. Për komponentët e tjera të pjesëmarrjes ka nevojë për harmonizim.**



- **Nuk ka ndonjë institucion të veçantë për të monitoruar a po respektohen të drejtat e PAK. Edhe pse secili ligj e ka përcaktuar se kush është përgjegjës për zbatimin e tij.**



- Në Kosovë, vetëm për aftësinë e kufizuar merret KPAK në nivel qendror dhe Komitetet Konsultative në nivel lokal.  
KPAK – Këshilli për Personat me Aftësi të Kufizuar.  
Edhe ZQM e ka një zyrtare vetëm për Aftësinë e Kufizuar.  
ZQM-Zyra për Qeverisje të Mirë



Në këtë raport gjithashtu është një formë e përmbledhur e Analizës së Kornizës Ligjore të Kosovës për qasje dhe pjesëmarrje.

Në kolonën e fundit janë dhënë rekomandime për ndryshime, plotësime dhe hartim legjislativ të ri për këto dy çështje.

- Në këtë stad, për aftësinë e kufizuar ne rekomandojmë që:



- Institucionet e Kosovës në afat sa më të shkurtër të bëjnë rishikim strukturor të kornizës legjislative dhe institucionale;
- Të harmonizojnë atë me standardet e kërkuara të KDKPAK,
- Para rishikimit duhet një analizë e vlerësimit nga një sistem i vlerësimit kombëtar për standardet e aftësisë së kufizuar
- Adresimin e politikave të qasjes si parakushte për pjesëmarrje efektive në jetën publike dhe realizimin e të drejtave për PAK.





- Megjithatë, në muajt në vijim një raport i veçantë me rekomandime specifike do të përgatitet dhe prezantohet.



- Si dhe kujt do ti shërbejë raporti ?

Raporti do tu shërben institucioneve të Kosovës:

- Si udhërrëfyes për adresimin e plotë të çështjeve të aftësisë së kufizuar në hartimin e politikave dhe legjislacionit adekuat.

Sepse ka boshllëqe të mëdha ligjore në këto çështje në përgjithësi dhe posaçërisht në fushat në shënjestër të kësaj analize.





- Raporti do tu shërbejë organizatave të personave me aftësi të kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar:
  - të avokojnë tek institucionet publike në nivel nacional dhe lokal, përfshirë ato ligjvënëse dhe të administratës



Për adresimin e çështjeve fundamentale në mënyrë që kjo pjesë e shoqërisë të mund të gëzojë të drejtat e garantuara.



- Ky raport dhe raportet tjera duhet të përdoret për të adresuar çështjet e aftësisë së kufizuar.

Harmonizimi i infrastrukturës ligjore të Kosovës duhet të garantojë një përputhshmëri me standardet e kuadrit të KDPAK.



**Autori:**

**Latife Neziri- Avokate-Avokatura Lexius, Ferizaj**

**Mbështetur nga HANDIKOS Kosova**

**Grupi Punues Legjislativ për Qasje:**

**Rukije Gashi, Besim Galica, Besart Ramadani, Bekim Krasniqi,  
Bedri Kadriu**

**Grupi Punues Legjislativ për Pjesëmarrje:**

**Mimoza Rrahmani, Musa Shigjeqi, Emira Kuqani, Lirik Krasniqi,  
Enver Kurtalani, Daut Tishuku**

**Përkthimi dhe redaktimi: Dukagjin Kelmendi**

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA) dhe as konsorciumit SMART Balkans.

**Publikimi i nënshtrohet të drejtës së autorit. Mund të riprodhohet pa pagesë apo leje paraprake për qëllime të tjera, por jo për rishitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leja paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi. ©**

